



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 163/1 Prot

Tiranë, më 2/3/2015

Lënda: *Jepet mendim për një projektudhëzim*

Drejtuar: **AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Për dijeni: **MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.244/1 prot, datë 19.02.2015, projektudhëzimi “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në sektorin e transportit ajror” sipas argumentimit të bërë vjen si rrjedhojë e transpozimit në të, të Direktivës 95/46, datë 24 tetor 1995 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, zbatimit që kërkon ligji nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës,...”, Ligjit nr.10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në shkresën përcjellëse thuhet se, qëllimi i këtij projekt/udhëzimi do të jetë zbatimi i përpunimit të të dhënave personale në tërësi ose pjesërisht me mjete automatike, dhe përpunimi me mjete të tjera nga ato automatike të cilat janë pjesë e një sistemi depozitimi ose kanë për qëllim të jenë pjesë e një sistemi depozitimi/arshivimi. Ndërsa, nga përmbajtja e p/aktit rezulton se në të përfshihet thuajse e gjithë përmbajtja e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në vijim, përsa informoni dhe keni parashikuar në përmbajtje të p/aktit, vlerësojmë se ai nuk është në përputhje me parashikimet e mësipërme, pasi transpozimi i Direktivës 95/46 datë 24 tetor 1995 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit është përbushur me miratimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, rrjedhojë e të cilit është edhe ngritja e funksionimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe ushtrimi i përgjegjësisive për monitorimin e këtyre të drejtave.

Gjithashtu, miratimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale vjen pas ratifikimit të “Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnje Hercegovinës,...” miratuar me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006, çka nënkupton marrjen në konsideratë të implementimit të saj në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Në përgjegjësitë e Komisionerit, në nenin 31/1 është parashikuar shprehimisht se “Komisioneri është përgjegjës për, *f*) nxjerrjen e udhëzimeve për marrjen e masave të sigurisë në veprimtarinë e sektorëve të veçantë”, ndërsa në pikën 1/a të po këtij neni parashikohet se Komisioneri është përgjegjës për “*dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë*”.

Në vështrim të këtyre dispozitave si dhe qëllimit specifik që keni për të normuar përpunimin e të dhënave personale në një fushë të caktuar të veprimtarisë së punës tuaj apo në disa fusha, do të mund të përcaktohet rruga që duhet ndjekur për hartimin e këtij projekt-akti.

Pra, nëse udhëzimi do ishte i karakterit të përgjithshëm duke përfshirë fazat e përpunimit të të dhënave personale, etj, atëherë akti do të duhet të hartohet nga autoriteti juaj dhe më pas të dërgohet për mendim pranë Zyrës së Komisionerit. Në rast se qëllimi i hartimit të aktit do të synojë përcaktimin e masave të sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale në një sektor të veçantë (p.sh kategoria e punonjësve apo pasagjerëve), atëherë p/akti do të duhet të hartohet në bashkëpunim me KDIMDP. Për këtë, paraprakisht identifikohen problematikat dhe nevojat e shfaqura në veprimtarinë e punës suaj sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe më tej ato adresohen për tu normuar ligjërisht në bashkëpunim me KDIMDP.

Më konkretisht, ndër të tjera projekt-akti duhet të përmbajë:

- Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen dhe subjektet e të dhënave;
- Qëllimin e përpunimit;
- Nivelet e aksesit të kufizuar;
- Masat e sigurisë për përpunimin manual dhe elektronik/automatik;
- Rregulla mbi përhapjen dhe transferimin e të dhënave;
- Afatet e përpunimit dhe mbajtjes së të dhënave personale;
- Të drejtat e subjekteve dhe detyrimet tuaja si kontrollues;
- Mënyrat dhe procedurat e shkatërrimit të të dhënave personale.

Përveç sa sipër, sugjerojmë që në zbatim të Marrëveshjes së sipër cituar dhe në kuadër të plotësimit të detyrimeve që parashikon ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (neni 27), të hartoni rregulloren e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale përfshirë në të masat e sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale në të gjithë veprimtarinë e Autoritetit tuaj. KDIMDP ka publikuar në faqen e tij zyrtare, formatin e “Rregullores Tip” e cila mund t’ju ndihmojë në hartimin e saj.

Gjithashtu, gjejmë me vend t’ju informojmë edhe mbi përmbushjen e detyrimit ligjor për të bërë njoftimin përkatës (referojuni për këtë nenit 21 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008), pranë Zyrës së Komisionerit, lidhur me përpunimin e të dhënave personale, detyrim i konstatuar ende i pa

realizuar nga autoriteti juaj si dhe të caktoni personin e kontaktit/të ngarkuar sipas kriterëve të referuara në Udhëzimin nr.21, datë 24.09.2012, i ndryshuar i Komisionerit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

